



REBULIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SIGURISË KOMBËTARE

PLANI VJETOR I PARANDALIMIT TË KORRUPSIONIT
TË AGJENSISË PËR SIGURI KOMBËTARE PËR VITIN 2024

Shkup, prill, 2024

PËRMBATJA

I. Hyrje

II. Objektivat dhe kompetencat e Agjencisë për Siguri Kombëtare

III. Termat bazë sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interstit

IV. Arsytet (Shkaqet), kushtet dhe faktorët që mundësojnë korrupsionin

V. Zonat e identifikuar të ndjeshme ndaj korrupsionit në kuadër të fushës së punës së Agjencisë së Sigurisë Kombëtare

VI. Mjetet dhe mekanizmat e kontrollit për tejkalimin e zonave të rrezikut të zbuluar

VI. Mjetet ekzistuese dhe mekanizmat e kontrollit në kuadër të ligjit aktual dhe në përputhje me Ligjin e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare

VI.II Mjetet dhe mekanizmat e kontrollit që duhet të krijohen

VII. Ngritja e integritetit të punësuarve

VIII. Bashkëpunim ndërinstitucional

I. Hyrje

Plani vjetor i Agjencisë së Sigurisë Kombëtare për parandalimin e korrupsionit për vitin 2024 është rezultat i angazhimit të përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe është në pajtueshmëri me rekomandimet e Qeverisë, dokumentet strategjike dhe rregulloret përkatëse nga kjo fushë.

Korrupsioni është problem serioz për përparimin e vendit dhe është kërcënim që ka për qëllim cënimin e sistemit ekonomik dhe të përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe vlerave dhe interesave themelore të përcaktuara me kushtetutë.

Plani vjetor kundër korrupsionit synon të identifikojë masat dhe aktivitetet që do të mundësojnë luftën kundër korrupsionit dhe të identifikojë shkaqet, kushtet dhe faktorët që e mundësojnë atë.

Agjencia e Sigurisë Kombëtare, nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve normative dhe institucionale, do të përpiqet të krijojë, zhvillojë dhe zbatojë mekanizma efikasë dhe funksionalë që do të ulin rreziqet e korrupsionit

Plani Vjetor ofron një pasqyrë të qëllimeve dhe kompetencave të Agjencisë, koncepteve bazë në pajtim me Ligjin e Parandalimit të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, zonat e identifikuara të rrezikut të prira për korrupsion brenda fushëveprimit të veprimit, shkaqet, kushtet dhe faktorët që mundësojnë korrupsioni, mjetet dhe mekanizmat e kontrollit për parandalimin dhe reduktimin e rrezikut të korrupsionit, forcimin e integritetit të punonjësve, si dhe bashkëpunimin ndërinstytucional.

II. Objektivat dhe kompetencat e Agjencisë

Me Ligjin e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 108/19), për mbrojtjen e sigurisë kombëtare të shtetit, gjegjësisht për mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit, rendit kushtetues, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe çështje të tjera me interes e sigurisë kombëtare të vendit, u themelua Agjencia e Sigurisë Kombëtare si organ i pavarur i administratës shtetërore me cilësi të personit juridik.

Agjencia si një nga subjektet e bashkësisë së sigurisë dhe inteligjencës (zbulimit) në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e sigurisë kombëtare të vendit, duke ruajtur stabilitetin social, ekonomik dhe politik të nevojshme për mbijetesën e saj, si dhe ruajtjen e rendin kushtetues dhe zbatimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe shtetasve të garantuara me Kushtetutë.

Kompetencat e Agjencisë janë të përcaktuara saktësisht në Ligjin e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare, i cili përcakton se Agjencia mbledh, përpunon, analizon, vlerëson, shkëmben, ruan dhe mbron të dhënat dhe informacionet me qëllim zbulimin dhe parandalimin e aktiviteteve që lidhen me kërcënimet e sigurisë dhe rreziqet për sigurinë kombëtare të vendit, si më poshtë:

- spiunazhi,
- terrorizmi dhe financimi i tij,
- ekstremizmi i dhunshëm,
- të gjitha format e veprimtarive të rënda kriminale dhe të organizuara të drejtuara kundër shtetit,
- parandalimi i krimeve kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare.
- prodhimi dhe përhapja e paligjshme e armëve të shkatërrimit në masë ose përbërësve të tyre, si dhe materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për prodhimin e tyre.
- cenimi i interesave jetike ekonomike dhe sigurisë financiare të shtetit,
- çrregullimi i sigurisë së bartësve të funksioneve të larta shtetërore,
- dhe i objekteve me rëndësi strategjike të shtetit,
- zbulimin dhe parandalimin e aktiviteteve të tjera që lidhen me kërcënimet dhe rreziqet e sigurisë për sigurinë kombëtare të vendit.

Agjencia gjithashtu kryen kontrole të sigurisë në pajtim me Ligjin e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare dhe ligje të tjera

III. Termat bazë në pajtim me Ligjin e Parandalimit të Korrupsionit dhe të Konfliktit të Interesit

Në tekstin e planit vjetor për parandalimin e korrupsionit për vitin 2024, termat e përdorur kanë kuptimin e përcaktuar në Ligjin e Parandalimit të Korrupsionit dhe të Konfliktit të Interesit, si vijon:

- **Korrupsion** - shpërdorimi i detyrës, autoritetit publik, detyrës zyrtare ose pozitës për përfitime, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, për veten ose për tjetrin që mund të përfshijë:
- **Korrupsion pasiv** - veprim i qëllimshëm i një zyrtari i cili, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, kërkon ose merr përfitime të çdo lloji, për vete ose për një palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë në mënyrë që të veprojë ose të përmbahet nga të vepruarit në pajtim me detyrimet e tij ose të ushtrijë kompetencat e tij në kundërshtim me detyrat e tij zyrtare, dhe
- **Korrupsioni aktiv** - veprim i qëllimshëm mbi çdo person që drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, premtion ose përfiton nga çdo lloj zyrtari, për të ose për palë të tretë, me qëllim që të veprojë ose të përmbahet nga të vepruarit në pajtim me detyrat e tij/saj ose të kryejë kompetencat e tij/saj në kundërshtim me detyrat e tij/saj zyrtare.
- **Konflikti i interesit** - situatë në të cilën zyrtari ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë në kryerjen e paanshme të kompetencave të tij publike ose detyrave zyrtare.
- **Përfitim** - realizimi i çdo lloji përfitimi të prekshëm ose të paprekshëm, komoditeti ose avantazhi për veten ose për tjetrin.
- **Rreziku i korrupsionit** - çdo lloj dobësie ose procedure e brendshme ose e jashtme, që paraqet mundësi të korrupsionit brenda organeve shtetërore, ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të tjera të sektorit publik dhe që përfshin çështje të konfliktit të interesit, paputhshmërisë së funksioneve, pranimit të dhuratave dhe pagesat të tjera të paligjshme, lobimi, mungesa e sistemit të mbrojtjes së sinjalizuesve, mashtrimi, përdorimi i pahijshëm i kompetencave, kompetencat e besueshme, financimi i partive politike dhe fushatat kundër ligjit, tregtimi ose përdorimi i paligjshëm i informacionit, transparenca e procedurave dhe dokumenteve dhe çështje të tjera të rëndësishme për integritetin.

- **Integriteti** - kryerja ligjore, e pavarur, e paanshme, etike, e përgjegjshme transparente e aktiviteteve me të cilat zyrtarët ruajnë reputacionin e tyre dhe reputacionin e institucionit në të cilin janë përgjegjës, gjegjësisht të punësuar, eliminojnë rreziqet dhe largojnë dyshimet për mundësinë e shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit duke u ofruar kështu qytetarëve besim në kryerjen e funksioneve publike në punën e institucioneve publike.

IV. Shkaqet, kushtet dhe faktorët që e mundësojnë korrupsionin

Shkaqet kryesore që e mundësojnë korrupsionin në institucione dhe në përgjithësi të gjitha nivelet është ekzistimi i mospërputhjeve, paqartësive dhe zbrazëtirave në legjislacion në rregulloret e fushave të ndryshme, mospërputhja e ndërsjellë e ligjeve, mungesa e masave për eliminimin afatgjatë të korrupsionit, mungesa e mekanizmave të kontrollit etj.

V. Zonat e identifikuar të ndjeshme ndaj korrupsionit në kuadër të fushës së punës së Agjencisë së Sigurisë Kombëtare

Fushat e rrezikut për korrupsion në kuadër të fushëveprimit të Agjencisë së Sigurisë Kombëtare rrjedhin nga specifikat e kompetencave të Agjencisë të përcaktuara me ligj.

Në përgjithësi, rreziku i korrupsionit mund të identifikohet si:

- rreziku i keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar;
- rreziku i zbulimit të informacionit të klasifikuar;
- rreziku i sjelljes joprofesionale në veprim ose mosveprim të punonjësve në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare nën ndikimin e korrupsionit;
- mosrespektimi i rregullave dhe rregulloreve të Agjencisë së Sigurisë Kombëtare;
- rreziku në fushën e prokurimit publik nga konflikti i interesave, veprimet korruptive të personave të ngarkuar me përgatitjen e specifikimeve teknike për prokurimin publik, gjatë planifikimit të furnizimit publik, si dhe rreziku i ndikimit, nepotizmit, klientelizmit dhe kronizmit.

VI. Mjetet dhe mekanizmat e kontrollit për tejkalimin e zonave të rreziqeve të zbuluara

VI.I Mjetet ekzistuese dhe mekanizmat e kontrollit në pajtim me kuadrin ligjor aktual dhe Ligjin e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare

Si pjesë e detyrimeve ligjore, Agjencia e Sigurisë Kombëtare ka vendosur masa dhe aktivitete që janë të dobishme në fushën e parandalimit dhe uljes së rrezikut të korrupsionit, si dhe disa nga mjetet dhe mekanizmat e kontrollit janë të përcaktuara në Ligjin për Agjencinë e Sigurisë Kombëtare, si:

- Agjencia e Sigurisë Kombëtare ka caktuar person të autorizuar për pranimin e aplikacioneve të paraqitura për mbrojtjen e brendshme dhe raportimin sipas Ligjit të Mbrojtjes së Informatorëve dhe ka përgatitur akte të brendshme për mënyrën e veprimit për raportim të mbrojtur të brendshëm dhe të jashtëm;

- Agjencia e Sigurisë Kombëtare ka caktuar person zyrtar për të ndërmjetësuar në ushtrimin e të drejtës për qasje të lirë në informacion;

- Ligji i Agjencisë së Sigurisë Kombëtare ka caktuar një person përgjegjes për këshillim në fushën e integritetit, konflikt të interes, marrjen e dhuratave (bakshisheve) apo te ngjashme, si dhe person të autorizuar për rregullimin e dhuratave (bakshishe).

- Agjencia e Sigurisë Kombëtare ka miratuar Kod të Etikës për Punëtorët, qëllimi i të cilit është zbatimi i standardeve dhe vlerave etike për realizimin e kompetencave ligjore të Agjencisë, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, interesit publik dhe të mirës publike, hierarkisë dhe nënshtrimit, profesionalizmit, besnikërisë, objektivitetit, neutralitetit politik, integritetit, besueshmërisë, përgjegjësisë dhe efikasitetit, ekonomisë dhe efektivitetit. Mosrespektimi i Kodit është bazë për përgjegjësinë disiplinore dhe sanksionimin e punonjësve të Agjencisë;

- Agjencia e Sigurisë Kombëtare ka miratuar procedurën e planifikimit për zbatimin e furnizimeve publike dhe ekzekutimin e kontratave për furnizimet publike, si dhe procedurat në fushën financimit të punës në Agjenci.

- Ligji i Agjencisë së Sigurisë Kombëtare paraqet kuadër ligjor solid në pjesën e rendit juridik të mbikëqyrjes së funksionimit të Agjencisë nga organet mbikëqyrëse: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut drejtpërdrejt dhe përmes organeve kompetente punuese, Avokati i Popullit, Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Enti Shtetëror i Revizionit, Këshilli i Mbikëqyrjes Civile dhe organe të tjera mbikëqyrëse. Organet mbikëqyrëse kanë të regulluara saktësisht për ushtrimin e kontrollit dhe të mbikëqyrjes së punës, shfytëzimin e mjetëve, ekzekutimin e Buxhetit të Agjencisë, ekzekutimin e profesionalizmit etj.

- Në fushën e llogaridhënies dhe transparencës, Agjencia vepron në pajtim me detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare dhe aktet nënligjore për mënyrën e informimit dhe komunikimit me publikun.

VI.II Mjetet dhe mekanizmat e kontrollit që duhet të vendosen

Agjencia e Sigurisë Kombëtare, në pajtim me zonat e identifikuara të ndjeshme ndaj korrupsionit, do të vazhdojë në të ardhmen të krijojë mjete dhe mekanizma kontrolli që do të kapërcejnë sfidat dhe do të parandalojnë ose minimizojnë faktorët që mundësojnë korrupsionin.

Në këtë kontekst, Agjencia do të ndërmarrë këto aktivitete

- Demonstrimi i vullnetit të drejtuesve të lartë të Agjencisë së Sigurisë Kombëtare në parandalimin e korrupsionit dhe konflikt interesit (tone from the top);

- Vlersim i vazhdueshem dhe në kohë të rreziqeve reale;

- Vendosja e dixhitalizimit perms zgjedheve modern softuerike ne te gjitha sferat e funksionimit.

- Rrespektim i vazhdueshëm i parimeve të përcaktuara në Ligjin për Buxhet gjatë percaktimit te planit financiar (buxhetin) të Agjencisë dhe lajmërim për ekzekutimin e tij;

- Promovim dhe përkrahje të iniciativës nga të gjithë punojnësit e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare për antikorrupsion, etikë dhe pajtueshmëri në punë;

- Zbulim aktiv, trajtim dhe sanksionim në rastet e mundëshme të korrupsionit dhe konflikt interesit;

- Forcim i integritetit individual të çdo anëtarit të Agjencise, si dhe në tërësi të kapacitetit institucional te Agjencise per sukses kunderkorrupsionit dhe parandalimin e tij;

- Forcim I personelit ekipor në njesitë organizative kompetente për kontrollim të brendshem, revizon të brendshem, si dhe furnizimeve publike;

- Forcimi i rolit të personit të autorizuar për pranimin e denoncimeve të dorëzuara me qëllim të raportimit të brendshëm të mbrojtur sipas Ligjit të Mbrojtjes së Informatorëve;

- Respektimin e përpiktë të rregullativës ligjore, aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme të Agjencisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre në pajtim me dobësitë dhe nevojat e konstatuara;

- Edukimi i vazhdueshëm përmes një sistemi trajnimesh për të gjithë punëtorët në fushën e antikorrupsionit;

- Inicimi i ndryshimeve ligjore me qëllim përcaktimin e kriterëve, kushteve dhe standardeve për punonjësit që do të kontribuojnë në parandalimin dhe uljen e rrezikut të korrupsionit

- Përgatitjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave të shkruara për zbatimin e procedurave të prokurimit publik, realizimin e kontratave dhe magazinimin, me qëllim që të sigurohet zbatimi i duhur i kornizës normative për prokurimin publik;

- Respektim i përpiktë i parimeve bazë të Kodit të sjelljes në kryerjen e furnizimit publik;

- Vendosja e sistemit të brendshëm për mbikëqyrjen dhe kontrollin e procedurave të furnizimit publik dhe monitorimin me shumë shtresa (vertikale dhe horizontale) të të gjithë dokumentacionit dhe fazave të prokurimit publik, duke përfshirë analizën e prokurimeve të mëparshme me një raport gjithëpërfshirës për arsyet e mosrealizimi;

- Vendosja e praktikës për raportimin e rasteve të rreziqeve të mundshme te personi përgjegjës për integritetin, pranimin e dhuratave dhe konfliktin e interesit;

- Trajnimin e vazhdueshëm dhe ngritjen e njohurive të punonjësve të kualifikuar dhe profesionistë për kryerjen e furnizimeve publike, motivimin dhe rritjen e tyre në karrierë;

- Ndryshim periodik të Planit për parandalim të korrupsionit

VII. Forcimi i Integritetit të punjonësve

Në kuadër të strukturës organizative të Agjencisë së Sigurisë Kombëtare është krijuar njësi e posaçme organizative për kontrollin e brendshëm, e cila ndër të tjera ka kompetencë të përcaktuar me ligj për të vlerësuar ligjshmërinë dhe respektimin e standardeve profesionale në Agjenci, si dhe puna për ankesat, konflikti i interesit dhe rreziqet e korrupsionit, në bashkëpunim me organin kompetent.

Duke pasur parasysh fushat e identifikuar që janë të ndjeshme ndaj korrupsionit, forcimi i integritetit profesional të stafit të Agjencisë mbetet një nga përgjegjësitë kryesore.

Agjencia për Siguri Kombëtare në pajtueshmëri me strukturat e organizuara si dhe me njësitë e revizionit të brendshëm të cilat janë në pajtueshmëri me kompetencat të rregulluara me ligj për të marrë veprime për parandalim dhe detektim të korrupsionit dhe konflikt interesit në kuadër të Agjencisë.

Integriteti është parimi i sjelljes së qëndrueshme në pajtim me vlerat dhe parimet etike. Mund të konsiderohet si integriteti i individëve dhe integriteti i organizatës. Në këtë drejtim, po përgatitet test integriteti në mënyrë që Agjencia e Sigurisë Kombëtare të vazhdojë të punojë për forcimin e integritetit në të gjitha nivelet. Punonjësit e Agjencisë duhet të kenë njohuri dhe aftësi, kapacitet etik, vendosmëri dhe profesionalizëm, si dhe t'i kryejnë detyrat e punës duke respektuar rregullat dhe procedurat e vendosura që do të jenë në interes të publikut dhe do të kontribuojë në rritjen e besimit të publikut.

VIII. Bashkëpunimi nderinstitucional

Në kryerjen e funksionit të saj, përfshirë edhe në pjesën e zbulimit dhe parandalimit me kohë të veprimeve korruptive, Agjencia realizon bashkëpunim të ngushtë me organet dhe institucionet tjera shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht nënshkruan memorandume dhe protokolle për bashkëpunim me organet shtetërore, ndërmarrjet publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe personat e tjerë juridikë, me qëllim mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve zyrtare për realizimin pa probleme të kompetencave të tyre.

Në fushën e korrupsionit, Agjencia do të vazhdojë të punojë në forcimin e bashkëpunimit me institucionet kompetente shtetërore, duke mbajtur takime, shkëmbim informacionesh, lidhje memorandume dhe të gjitha format e tjera të aktiviteteve.

Nr. _____

_____ viti 2024

SHKUP

DREJTORI
I AGJENCISË PËR SIGURI KOMBËTARE
Zarko Miloshevski